



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOHËS SË TRANSMETIMIT NË RADIOTELEVIZIONIN PUBLIK, TË FUSHATËS ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimi i kohës së transmetimit në Radiotelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", neni 80, pika 1 germa "b" dhe "c", i Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Neni 80, pika 1, i Ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore për të bërë fushatë zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në urdhërimet e pikës "b" dhe "c" të kësaj dispozite, cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare.



Nr . 727 i vendimit Data 30.05.2019 e vendimit Ora 17:00 e vendimit

Caktimi i kohës së transmetimit në Radiotelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

Partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 përqind të vendeve në Kuvend, KQZ-ja i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta në Televizionin Publik dhe jo më pak se 15 minuta në Radion Publike. Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike.

Me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvendin, rezultojnë se:

- Partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, janë:

1. PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

- Partitë e tjera parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 janë:

1. PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË

Gjithashtu, si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019, janë regjistruar në KQZ edhe 34 parti politike joparlamentare, të cilat në bazë të përcaktimeve të nenit 80, pika 1, germa "c", përfitojnë 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike, si dhe janë regjistruar edhe 16 kandidat të propozuar nga zgjedhësit të cilët sipas praktikës së krijuar nga KQZ, dhe radiotelevizioni publik, duhet të përfitojnë 5 minuta në Televizion dhe 5 minuta në Radion Publike.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 80 pika 1, germa "b" dhe "c", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 60 minuta, përkatësisht në Televizionin dhe Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare si më poshtë:

1. PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË

2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 30 minuta përkatësisht në Televizionin dhe Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare si më poshtë:

1. PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË



Nr . 727 i vendimit Data 30.05.2019 e vendimit Ora 17:00 e vendimit

Caktimi i kohës së transmetimit në Radiotelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 minuta përkatësisht në Televizionin dhe Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive joparlamentare si më poshtë:

1. Partia Demokracia Sociale
2. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare
3. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare
4. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
5. Partia G99
6. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
7. Partia Ardhmëria Shqiptare
8. Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet
9. Partia e Gjelbër
10. Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar
11. Partia Kristian Demokrate
12. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
13. Partia e të Drejtave të Mohuara
14. Partia Unitetit Kombëtar
15. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare
16. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve
17. Partia Socialiste e Moderuar
18. Partia Socialpunëtore Shqiptare
19. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
20. Partia Aleanca Kuq e Zi
21. Partia Bashkimi Liberal Demokrat
22. Partia Demokracia e Re Europiane
23. Partia Balli Kombëtar
24. Partia Ora e Shqipërisë
25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë
26. Partia Kombëtare Konservatore Albania
27. Partia Emigracionit Shqiptar
28. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar
29. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
30. Partia për Liri Demokraci dhe Etikë
31. Fryma e Re Demokratike
32. Partia Komuniste e Shqipërisë
33. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European
34. Partia Bindja Demokratike

4. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 5 minuta përkatësisht në Televizionin dhe Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për secilin prej 16 kandidatëve të pavarur,

- 1) Z. Fezi Xheladin Shaholli;
- 2) Z. Leonidha Vasil Hristo;
- 3) Z. Bedri Selman Hoxha;
- 4) Z. Gjon Gjete Ndoj;
- 5) Z. Ilir Hasan Nikolla;
- 6) Z. Plarent Xhorxhi Aleksi;



Nr . 727 i vendimit Data 30.05.2019 e vendimit Ora 17:00 e vendimit

Caktimi i kohës së transmetimit në Radiotelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

- 7) Z. Albert Rrapush Shopi;
- 8) Z. Fran Ndue Jushi;
- 9) Z. Baki Avni Jazaj;
- 10) Z. Mehmet Sheref Nelaj;
- 11) Znj. Majlinda Adem Ndrecaj;
- 12) Znj. Silva Jorgji Burbo;
- 13) Z. Vasillaq Harrilla Bollano;
- 14) Z. Petro Ziso Bozhori;
- 15) Z. Areti Aristidh Nasho;
- 16) Z. Mond Leter Loli;

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 727 i vendimit Data 30.05.2019 e vendimit Ora 17:00 e vendimit

Caktimi i kohës së transmetimit në Radiotelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019